

**VENDIM**  
**Nr.743, datë 8.9.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, për objektet “Ndërtim rruge, Unaza e Re e Tiranës – Mullet, loti 1”, “Ndërtim rruge, Rruga e Arbërit (Segmenti Dalje, Ura e Vashës – Bulqizë), loti 3” dhe “Ndërtim rruge, By Pass Plepa – Kavajë – Rrogozhinë, loti 4.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fyqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**